



SOS FSHATRA
E FËMIJËVE
KOSOVË

FTESE PER OFERTE

Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë është organizatë joqeveritare e përkujdesjes sociale e dedikuar për përkrahjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe në nevojë, pa marrë parasysh etninë, kombësinë dhe besimin fetar.

*SOS Fshatrat e Fëmijëve për nevojat e projektit regional “Fuqizimi dhe aftësimi të rinjëve përmes mundësive të reja – YEEP II”, projekt ky i cili zbatohet nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë në Maqedoninë Veriore, Shqipëri, Bosne e Hercegovinë, Serbi dhe në Kosovë, i financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillimor - BMZ dhe Fondit Hermann Gmeiner Gjermani – HGFD i cili ka për qëllim të përmirësojë mundësitë për punësim dhe pjesëmarrje aktive të të rinjëve në rrezik në tregun e punës, fton kompanitë e specializuara dhe të interesuara për të ofertuar për: **Blerjen e një veture të re me lizing***

Me këtë rast shpallim Ftesë për Ofertë për të gjitha kompanitë e autorizuarra për lizing të veturave

Kompanitë e interesuara mund të marrin specifikacionin deri me: **06.12.2023** në email adresën: procurement1@soskosova.org

Ofertuesi së bashku me ofertën duhet të dorëzojë:

- Çertifikatën e regjistrimit të biznesit/ NUI
- Çmimet duhen të kuotohen në euro pa tvsh (duke përfshirë të gjitha shpenzimet tjera përcjellëse nëse ka.
- Oferta duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur /apo në letër me logo zyrtare
- Dëshmi/ Autorizimi që jeni shitës dhe servis i autorizuar nga prodhuesi i automjeteve
- Në ofertë të ceken garancionet e veturës
- Afati i liferimit të veturës më së largu 3 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. (brenda muajit dhjetor 2023)

Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë (30 ditë) nga data e mbylljes së Ftesës për Ofertë

Me rastin e nënshkrimit të kontratës ofertuesi i përzgjedhur duhet të dorëzojë prova se personi përgjegjës dhe pronari i biznesit nuk janë nën hetime për vepra penale/ ose vërtetimin tatimor.

Ofertuesit e interesuar mund t'i dorëzojnë dokumentet dhe ofertën e mbyllur në pliko/ zarf (2 kopje), të nënshkruara nga përfaqësuesi ligjor dhe të shënuara me kodin “ **Oferta për Veturë**”. Ofertat duhet të dorëzohen deri me datën: **07.12.2023 në zyret e SOS Fshatrave të Fëmijëve Kosovë**, në adresën **Velani 1 Tetori, p.n. Prishtinë** çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00.